




Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja i Nauke, Tehnologije i Inovacija
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Udhëtimi nëpër internet



Financuar nga
Bashkimi Evropian

Zbatuar nga:



Udhëtimi nëpër internet

Udhëzues për nxënësit e
nivelit të mesëm të lartë

Autor: Mimoza Hasani Pillana

Redaktor: Avni Rexha dhe Merita Jonuzi

Lektor: Afrone Lila

Ky Udhëzues është përgatitur në kuadër të projektit “Mbrojtja e Fëmijëve të cenueshëm në Kosovë”, financuar nga Bashkimit Evropian (BE) në Kosovë dhe UNICEF në Kosovë, dhe implementuar në bashkëpunim me Qendra për Arsim e Kosovës – KEC. Materialet, përmbajtja dhe pikëpamjet e shprehura në këtë Udhëzues janë ato të ekspertit të angazhuar dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e BE-së, UNICEF-it dhe të KEC-it. Botimi nuk është redaktuar sipas standardeve zyrtare të publikimit të UNICEF-it dhe BE-së, të cilët nuk marrin përgjegjësi për ndonjë gabim drejtshkrimor.

Tabela e përmbajtjes

- 06** Hyrja dhe qëllimi
- 07** Rëndësia e mbrojtjes në internet
- 08** Këshilla për sigurinë online
- 12** Rregullat mbi sjelljet e përgjegjshme

01

Hyrja dhe qëllimi



Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit po bën përpjekje të vazhdueshme që krahas digjitalizimit të shkollave tona, të rrisë vetëdijen dhe ndërgjegjësimin e nxënësve mbi aspektet e mbrojtjes përgjatë përdorimit të teknologjisë informative. Konteksti i mbrojtjes është obligim që rrjedh nga legjislacioni në fuqi i fushës, qoftë ai i fushës kibernetike dhe i aspekteve të mbrojtjes së të dhënave dhe privatësisë, qoftë ai që rregullon mbrojtjen e fëmijës. Më konkretisht, në nenin 37 të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji Nr. 06/L-084), pika 5.11 obligon Ministrinë e Arsimit, si autoritet publik përgjegjës, si dhe njësitë arsimore nga pushteti lokal që të marrin masa konkrete, me qëllim që të sigurojnë mbrojtjen e fëmijës në internet, duke promovuar përdorimin e teknologjisë informative të komunikimit, në mënyrë të dobishme dhe përgjegjshme. Në këtë linjë, në funksion të parandalimit, shkolla duhet t`u ofrojë dije e shkathtësi për t`u mbrojtur nga rreziqet online dhe ndërgjegjësim e shprehi të mira, për të promovuar kulturë të lartë të komunikimit dhe punës në internet. Politika e mbrojtjes nga rreziqet online duhet të jetë pjesë e punës së përditshme e të gjitha subjekteve brenda shkollës, ku secili duhet t`i kontribuojë punës cilësore, përdorimit të rregullt të teknologjisë dhe shmangies nga çdo lloj abuzimi. Është më se e ditur që përdorimi i internetit në kohën e sotme mbizotëron çdo formë komunikimi dhe fëmijët e të rinjtë, por edhe të gjitha moshat, janë përdorues të mëdhenj të internetit, i cili është det burimesh, mundësish, por edhe rreziqesh.

Ky udhëzues u dedikohet nxënësve të klasave 10-12, pra të nivelit të arsim-it të mesëm të lartë, atyre që duke qenë përdorues të mëdhenj të internet-it, të jenë të kujdesshëm e të përgjegjshëm gjatë përdorimit të internetit, përtej mundësive që të janë eksplorues të botës digjitale, me shkathtësi të mëdha, shpeshherë të jashtëzakonshme.

Atëherë të dashur nxënës, duke qenë se kompetencën digjitale e zhvillon përgjatë mësimave tuaja në shkollë dhe në jetë, ne duam t`ju kujtojmë rëndësinë e mbrojtjes në internet, si domosdoshmëri e kohës.



Qëllimi i këtij udhëzuesi është ofrimi i këshillave dhe i udhëzimeve ndërgjegjësuese për përdorimin e dobishëm, kujdesshëm dhe të përgjegjshëm të internetit. Mënyra e dobishme lidhet me përdorimin për mësim, duke respektuar kohën e caktuar për hulumtim, komunikim, informim, argëtim e lojë për zhvillimin tuaj intelektual, emocional e social, ndërkaq mënyra e përgjegjshme nënkupton përdorimin pa e dëmtuar veten dhe të tjerët, pa abuzim, pa ngacmim, e as shkelje të privatësisë dhe shkarje të tjera që janë të dënueshme me ligjet vendore dhe ndërkombëtare.

02

Rëndësia e mbrojtjes në internet



Të gjithë e dimë sa është i rëndësishëm interneti në ditët e sotme.

Ai e lehtëson komunikimin, informimin, hulumtimin, mësimin, por edhe realizimin e shërbimeve të shumta jetësore. Sipas rezultateve të Anketës së përdorimit të Teknologjisë Informativë dhe Komunikimit në Ekonomitë Familjare përqindja e ekonomive familjare që kanë pasur qasje në internet gjatë vitit 2023 është rreth 98,6%, përderisa grup-mosha me përqindjen më të lartë të qasjes në internet është grup-mosha 16-24 vjeç me rreth 21,5%. Pra, përdorimi i internetit na e ka lehtësuar jetën në shumë aspekte, na ka ofruar botën para syve, me larushinë që e ka ajo dhe secili mund të shohë e të përcjell zhvillimet globale, të përfshihet e të angazhohet në punën në distancë dhe të ndihet pjesë e një shoqërie të hapur. Por, krahas rëndësisë dhe dobive të shumta, zhvillimi i hovshëm i teknologjisë dhe qasja shumë e lehtë në informacione përmes inter-

netit, sjellë me vete edhe dinamikë tjetër pune, stil tjetër të jetës, por edhe rreziqe të shumta, ndaj të cilave duhet vëmendje e kujdes i shtuar.

Fakti se Kosova ka një nga nivelet më të larta të penetrimit të internetit në regjion dhe në botë, i bënë të gjithë përdoruesit e cenusëshëm, veçanërisht fëmijët. Andaj, rëndësia e mbrojtjes dhe përdorimit të sigurt të internetit është e madhe dhe domosdoshmëri e kohës.




Mbrojtja në internet nënkupton mbrojtjen nga abuzimet dhe nga keqpërdorimi online. Ndërgjegjësimi për rregullat e sjelljes online është parakusht për një edukim të mirë dhe për shmangie nga çdo formë dhune, ngacmimi apo rrethanë tjetër që dëmton dinjitetin dhe integritetin tuaj.

Nxënës të dashur, duhet ta keni prioritet mbrojtjen tuaj dhe të tjerëve në internet, gjatë shfrytëzimit të internetit! Duke qenë se tashmë, në moshën tuaj, keni shkathtësi të mëdha të përdorimit të internetit, sigurisht që ju duhet vetëm ndërgjegjësim për mënyrën e përdorimit, prandaj përvetësoni këshillat praktike dhe ndikoni te moshatarët tuaj për përdorimin e sigurt të internetit dhe qëndrimin sa më larg incidenteve të dhunës dhe abuzimeve online që ju dëmtojnë juve dhe të tjerëve përreth.

Çfarë duhet të dini?

Më sipër përmendëm qëllimin e këtij udhëzuesi dhe rëndësinë e përdorimit të internetit në mënyrë të mirë dhe të përgjegjshme. Jemi të vetëdijshëm se me zhvillimin dhe rritjen tuaj, sasia e informatave dhe shkathtësitë e juaja për të shfrytëzuar dhe përfituar nga përdorimi i internetit do të shtohet, andaj ky Udhëzues nuk duhet të shihet si një mjet kontrolli, por, si një udhërrëfyes që siguron që qasja juaj në internet të jetë sa më e sigurt. Duke pasur parasysh këto këshilla, do të jeni në gjendje të arrini një ekuilibër midis të gjitha mundësive pozitive dhe negative që ofron interneti. Na ndiqni!



03

Këshilla për sigurinë online



Shoqëria online

Kini kujdes kur zgjidhni shoqërinë me të cilën do të komunikoni online. Inkurajoheni që të krijoni raporte me njerëzit që njihni në jetën reale dhe të keni kujdes më të madh kur merrni parasysh pranimin e kërkesave për miqësi dhe për komunikim me të huajt/personat e panjohur online.

Komunikimi online

Tani që keni zgjeruar rrethin tuaj shoqëror, me siguri keni shtuar edhe rrjetin e komunikimit online. Edhe pse shoqja dhe shoku juaj mund të jenë shumë të afërt me ju në komunikim të përditshëm, kjo nuk do të thotë që ju duhet t'i ndani të dhënat personale për llogaritë tuaja në internet dhe madje duhet të jeni të kujdesshëm për çdo publikim që bëni në faqe të ndryshme qoftë edhe më miqtë më të mirë dhe familjarët. (Ilustrimi 1: ruaj të dhënat personale vetëm për vete! Ilustrimi 2: kërko miratim për publikim!)

Diversiteti social

Ju gjithashtu duhet t'i kushtoni më shumë vëmendje respektimit të diversitetit social, të drejtave tuaja dhe të bashkëmoshatarëve tuaj, përveç që duhet të jeni një përdorues i përgjegjshëm, duhet të jeni edhe një vëzhgues i mirë, që do të thotë se duhet të raportoni çdo rast kur cenohet dinjiteti i përdoruesve, kur përqeshet ndokush në internet, apo çdo rast të incidenteve kibernetike sipas rregullores së shkollës.

Kërkimi i informacionit online

Kërkimet në internet janë një pjesë e rëndësishme gjatë përdorimit të internetit. Ajo çka duhet të keni parasysh gjatë kërkimeve në internet është vërtetësia e informacionit. Për këtë, sugjerohet që informatat në internet të merren me rezervë dhe gjithherë të shikohet burimi dhe besueshmëria e informacionit.

Sa i përket kërkimit në internet është e rëndësishme të respektohen parimet etike gjatë hulumtimit/kërkimit. Etika e kërkimit si parime bazë përfshinë: saktësinë, objektivitëtin, dhe besueshmërinë e informacionit. Këto parime janë të lidhura ngushtë me ndershmërinë, si një kusht i domosdoshëm për etikën e kërkimit.

Çfarë do të thotë ndershmëri kur kërkon informacion?

Citimi i të dhënave nga të cilat është marrë informacioni, p.sh.: emri dhe mbiemri i autorit, titulli i librit ose artikullit, shtëpia botuese ose revista, viti i botimit, vendi i botimit, numri i faqes nga është marrë informacioni dhe linku nëse informacioni është marrë online.

Kujdes:

devijimi nga etika shkencore konsiderohet pandershmëri intelektuale dhe sanksionohet ligjërisht.

MOS HARRO, CITO!

VITI I BOTIMIT

AUTORI

VENDI I BOTIMIT

SHTËPIA BOTUESE

NUMRI I FAQES

Mendimi kritik

Të menduarit kritik, do të thotë të vlerësoni literaturën ose informacionin që po shqyrtoni, meqë jo çdo informacion që gjeni në internet është i vërtetë. (Ilustrim një llambë e ndezur ku shkruan: mbaj ndezur mendjen!)

Ju mund të pyesni se si krijohet të menduarit kritik?

Ka disa mundësi, por ato zakonisht zhvillohen në hapa të njëjtë: krijimi i informacionit nga burime të ndryshme, vlerësimi i burimeve, vlerësimi i informacionit, pyetjet dhe dëgjimi aktiv, të cilat janë pika kyçe që ndihmojnë në krijimin e të menduarit kritik.

MBAJ NDEZUR MENDJEN!



**MOS HARRONI TË
CITONI BURIMIN E
INFORMACIONIT!**



Imazhi yt në internet

Krijimi i një imazhi në internet kërkon gjithashtu vëmendjen tuaj, që do të thotë se jeni ju ata që do të krijoni imazhin tuaj në internet. Krijimi i imazhit është shumë i rëndësishëm pasi është një reflektim i juaj si në shkollë, ashtu edhe për universitetin apo çdo punë që do të filloni krahas moshës dhe të drejtave që gëzoni për punën.

Përdorimi i moderuar i internetit

Shkëputja nga pajisjet digjitale është një veprim i domosdoshëm për krijimin e një ekuilibri të shëndetshëm për ju. Pushimi nga ekranet dhe përfshirja në aktivitete të tjera relakson mendjen dhe trupin tuaj. Çfarë do të thotë kjo: caktimi i një orari për qëndrim në internet dhe respektimi i tij. (Një ilustrim sikur po pushon/relaksohesh dhe e shijon relaksimin).

Mos harroni se këto këshilla nuk i kemi shkruar që të ndërhyjmë në privatësinë, mësimin dhe argëtimin tuaj në internet, por që të ju kujtojmë se sjellja dhe komunikimi në internet/botën virtuale ka rregulla të caktuara, ashtu siç ka rregulla për sjelljen dhe komunikimin në botën reale.



04

Rregullat mbi sjelljet e përgjegjshme

Shmangia nga dhuna dhe abuzimi online



Dhuna digjitale është e pranishme në shoqëri dhe shkaktohet nga persona që internetin e përdorin për qëllime të këqija si: ngacmimi, shantazhi, kërcënimi, fyerja e poshtërimi. Sipas Rregullores QRK- nr. 21/2013 për Protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit para-universitar, dhuna digjitale nënkupton çfarëdo forme të dërgimit të mesazheve përmes internetit apo telefonisë mobile që ka për qëllim lëndimin, shqetësimin apo çfarëdo lloj tjetër të dëmtimit të fëmijës i cili nuk mund të mbrohet nga veprimet e tilla. Shfaqet në formë të video apo mesazheve tekstuale, fotografive apo thirrjeve. Çfarëdo situatë kur interneti keq-shfrytëzohet për të lënduar, përqeshur apo dëmtuar tjetrin është e ndaluar me ligj dhe akte nënligjore dhe është e dënueshme. Për më tepër, keq-shfrytëzimi i internetit për qëllime të tilla mund të gjurmohet nga organet kompetente dhe shumë shpejt të identifikohet kryesi. Shpeshherë ndodh që me ose pa vetëdije përdoruesit e internetit, e në veçanti fëmijët shumë lehtë mund të bien pre e konflikteve online. Andaj, duhet të kujdeseni për promovimin e sjelljes së shëndoshë dhe të qëndrimit kundër dhunës dhe abuzimit. Qoftë si ushtrues dhune apo si viktimë e dhunës, ju bini në situatë të vështira me presione e përplasje emocionale që ndikojnë në shëndetin dhe mirëqenien tuaj. Pastaj, nëse kësaj i shtohet edhe ndikimi i perceptimit e paragjytimeve nga rrethi familjar e shoqëror, trysnia e dëmi sa vijnë e rriten.

Komunikimi i shëndoshë



Komunikimi i shëndoshë është vlerë. Thjeshtë është komunikim korrekt, i sjellshëm dhe miqësor. Duhet pasur kujdes të vazhdueshëm që të mos komunikohet në mënyrë të vrazhdë, nënçmuese, të dhunshme, linçuese ose nxitëse për dhunë, urrejtje, mashtrim, shantazh, etj. Siç u tha më lart këto janë të dënueshme, sepse janë të dëmshme.

Komunikimi i shëndoshë, promovon paqe e mirëqenie. Si i tillë përçon pozitivitet dhe çon në rezultate të mira në marrëdhëniet ndërpersonale e shoqërore.



Ju këshillojmë t'i shmangeni çdo formë të dhunës online, sepse përveç presionit psikologjik, dhuna digjitale motivon dhe gjeneron edhe dhunën fizike dhe rrethana të tjera, të këqija e të rrezikshme.

Kurdo që pranoni mesazhe të papërshtatshme, fotografi, video apo përmbajtje tjetër të papërshtatshme në internet, ju lutemi që të ndiqni apo aplikoni këto udhëzime:

- Diskutoni për përvojat tuaja me bashkëmohatarë
- Diskutoni me mësimdhënës dhe me prindërit tuaj
- Ftoni për bashkëpunim ekspertë të fushës

Ndërkaq për efekt të sigurisë:

- Në bashkëpunim me prindërit apo mësimdhënësit tuaj, sigurohuni që pajisjet që i shfrytëzoni për qasje në internet të kenë të instaluar aplikacion apo soft-uerë të sigurisë
- Raportoni nëse keni hasur në ndonjë rrezik apo përmbajtje të pahijshme, kërcënuese apo diçka që ju shqetëson
- Aktivizoni filtrat e sigurisë në pajisjen tuaj digjitale.

Atëherë për veten konsideroni këto këshilla:

- Ruani të dhënat tuaja personale: emrin, adresën, vendbanimin
- Ruani fjalëkalimet në mënyrë të sigurt, krijoni fjalëkalime të forta
- Mos shpërfaqni gjendje emocionale dhe situata shumë personale në rrjete sociale, sepse mund t`ua keqpërdorin personat e papërgjegjshëm.

Ruajtja e privatësisë




Ruajtja e privatësisë është detyrim për çdo individ. Shkelja e privatësisë është e dënueshme me ligj, ngaqë i shkakton dëme individit, familjes së tij, etj. Gjatë procesit të edukimit ju e mësoni këtë gjë, ndërkaq këshillat dhe udhëzimet këtu i japim për ta sforcuar kulturën e sjelljes online dhe shmangien nga çdo formë e abuzimit apo shkeljeve eventuale.

Çfarë duhet të bëni?

Janë dy gjëra esenciale:

1. Të ruani privatësinë tuaj dhe
2. Të mos shkelni privatësinë e tjetrit.



Sa u përket të tjerëve:

- Mos keqpërdorni të dhënat e të tjerëve;
- Mos postoni fotografitë e të tjerëve pa pëlqimin e tyre;
- Mos abuzoni online me gjendjen apo situatën e të tjerëve.

Kufizimet përgjatë komunikimeve online



Sa u përket kufizimeve, përveç aspekteve të ruajtjes së privatësisë, ndalimit të shpërfaqjes së dhunës dhe nxitjes së urrejtjes, nënçmimit dhe cenimit të dignitetit të individit, të grupit apo edhe më gjerë, kufizimet janë të nevojshme edhe sa i përket vetë-menaxhimit të kohës së qëndrimit tuaj para pajisjeve të mençura apo në celular.

Shembuj

Rreziqet në internet.

Kujdes: qëndrimi në internet duke qenë i pakujdesshëm sjell rreziqe, jo vetëm përfitime.



Keqpërdorimi i të dhënave personale



Dhuna emocionale

Por, cilat janë rreziqet më të dukshme?



Shpifjet, publikimi i informacionit të rremë



Dëmtimet e shëndetit mendor dhe fizik, etj.



Prishja e imazhit

Materiale shtesë

1. Ligji për mbrojtjen e fëmijës

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=20844>

2. Ligji nr. 04/I-218 për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8875>

3. UA. 01/2019 për Mbrojtjen e fëmijëve në internet

<https://masht.rks-gov.net/ua-nr-01-2019-per-mbrojtjen-e-femijeve-nxeneseve-ne-internet-ne-institucionet-e-apu/>

4. Rregullorja 21/2013 për protokollin për parandalim dhe referim të dhunës në IAP

<https://masht.rks-gov.net/rregullore-qrk-nr-21-2013-per-protokollin-per-parandalimin-dhe-referimin-e-dhunes-ne-institucionet-e-arsimit-para-universitar/>

5. Udhëzuesi për zbatim të rregullores 21/2013

<https://masht.rks-gov.net/udhezus-per-zbatimin-e-rregullores-nr-21-2013/>

6. Doracak për parandalimin e dukurive negative në shkollat e mesme të larta

[HTTPS://MASHT.RKS-GOV.NET/DORACAK-PER-PARANDALIMIN-E-DUKURIVE-NEGATIVE-NE-SHKOLLA-TE-MESME-TE-LARTA/](https://masht.rks-gov.net/doracak-per-parandalimin-e-dukurive-negative-ne-shkollate-mesme-te-larta/)

7. Module tematike për mbrojtjen e fëmijës

[Module tematike përmbrojtjen e fëmijës - MASHT \(rks-gov.net\)](#)

8. UDHËZIM ADMINISTRATIV (QRK) NR. 04/2022 PËR MASAT PËR MBROJTJEN E FËMIJËS KUNDËR FAQEVE TË INTERNETIT ME PËRMBAJTJE PORNOGRAFIKE DHE TË ATYRE QË DËMTOJNË SHËNDETIN DHE JETËN E FËMIJËS

<https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/07/Udhezim-Administrativ-Nr-04-2022-per-masat-per-mbrojtjen-e-femjeve-kunder-faqeve-te-internetit-2.pdf>

Ky Udhëzues është përgatitur në kuadër të projektit "Mbrotja e Fëmijëve të cenueshëm në Kosovë", financuar nga Bashkimit Evropian (BE) në Kosovë dhe UNICEF në Kosovë, dhe implementuar në bashkëpunim me Qendra për Arsimit e Kosovës - KEC